



MINISTRIA E DREJTËSISË  
Nr. 7358 Prot. 6  
Datë 08 11 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

MINISTRI

Nr

Prot.

5474/B

Tiranë, 08/11/2016

**Drejtuar:** Z. Ylli MANJANI  
MINISTËR I DREJTËSISË ✓

Z. ARBEN AHMETAJ  
MINISTËR I FINANCËS

ZNJ. MILVA EKONOMI  
MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGËTISË DHE SIPËRMARRJES

ZNJ. ERMONELA FELAJ  
MINISTËR I SHTETIT PËR MARDHËNIET PËR PARLAMENTIN

Z. DAMIAN GJIKNURI  
MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIË

TIRANË

**Lënda:** Dërgohet për mendim një projektvendim

*Të nderuar kolegë,*

Bashkëlidhur ju dërgojmë për mendim projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënie me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë" si dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !



Lefter KOKA

MINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2016

PËR

**MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE  
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN  
ME KONCESION PËR NDËRTIM LANDFILLI, INCENERATORI DHE  
REABILITIM I VENDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 25, të ligjit nr.125/2013, datë 25.4.2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e bonusit prej 8 (tetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Integrated Energy B.V. Sh.p.k.” për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të ndërtimit të landfillit, inceneratorit reabilitimin e venddepozitimit ekzistues të Tiranës.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN E KESHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE**  
**KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN**  
**ME KONÇESION PËR NDËRTIM LANDFILLI, INCENERATORI DHE**  
**REABILITIM I VENDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë”, është një akt individual i cili bazohet në ligj me qëllim mbështetjen e shoqërisë që ka bërë propozimin e pakërkuar në procedurën konkurruese. Propozim ky i cili i shoqëruar nga dokumentacioni i dorëzuar është vlerësuar nga Komisioni përkatës me 8 pikë. Shoqëria që përfiton këtë bonus është Shoqëria “Integrated Energy B.V.” shpk. Aksioneret e kompanise të sipërcituar janë “Integrated Technology Services sh.p.k.”, “Paul Eürth Italia S.P.A” & “Energy Recuperator S.P.A.”.

Shoqëria ka bërë një propozim të pakërkuar për me koncesion të ndërtimit të landfillit të mbetjeve urbane, ndërtimit të landfillit të ujrave të ndotur, ndërtimit të landfillit të mbetjeve urbane, ndërtimin e venddepozitimit të hirit, ndërtimin e inceneratorit si dhe mbylljen dhe reabilitimin mjedisor të venddepozitimit ekzistues të Bashkisë Tiranë. Bëhet fjalë për një impjant kompleks I cili do ti

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”



vijë në shërbim të tërë Qarkut Tiranë për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbetjeve të ngurta. Propozimi I shoqërisë, vjen me një propozim fizibël nga ana ekonomike për një priudhë 30 vjecare të marrjes më koncesion.

Me anë të këtij propozimi, propozuesi merr përsipër, ndrtimin dhe administrimin e komplet impjantit për periudhën e konçesionit tërësisht me financim të tij. Pra kemi të bëjmë me një investim tërësisht privat

Ministria e Mjedisit, ka hartuar edhe më parë një VKM për miratim bonusi një shoqërie tjetër në procedurën e hapur koncesionare “Për dhënien me konçesion të ndërtimit dhe administrimit e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”. Metgjithëse shoqëria propozuese përfitoi një bonus prej 10 pikësh të barazvlefshëm me 10% të totalit të pikëve të procedurës, nga procesi i hapjes elektronike të ofertave, u konstatua se nuk paraqirti asnjë ofertë ekonomike për procedurën që vetë e kishte propozuar, duke mos marrë pjesë fare në garë. Ky fakt, tregon se shoqëritë, Autoritetet Kontraktore të cilat i clerësojnë me bonus, jo detyrimisht janë fituese të procedurave konkurruese, pasi kemi të bëjmë me procedurë të hapur, elektronike ku mund të marrin pjesë dhe të japin ofertën e tyre kushdo që ka interes.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projekt akt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe me politikën e Qeverisë për shfrytëzimin e energjisë së rinovueshme.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”

Menaxhimi i integruar i mbetjeve është një prej prioriteteve të programit të Ministrisë së Mjedisit dhe Qeverisë, për të plotësuar kërkesën në rritje për eliminimin e mbetjeve të vendit e sidomos të Qarkut Tiranë, si prodhuesi më i madh i mbetjeve në vënd, në këtë kuadër dhe Projektvendimi i Këshillit të Ministrave i propozuar është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave.

### **III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTVENDIMI**

Në zbatim të pikës 6 të nenit 25, të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, Ministria e Mjedisit ka shqyrtuar dhe vlerësuar projektin e propozuar për konçesion të shoqërisë “Integrated Energy B.V.”, pasi ka bërë analizën e rentabilitetit, fizibilitetit dhe të përshtatshmërisë teknike dhe financiare të projektit të paraqitur. Pas vlerësimit nga strukturat përgjegjëse, projekti është identifikuar si konçesion i mundshëm me interes publik. Efektet e pritshme janë se me ndërtimin e këtij impjanti, i cili është një bashkim i disa impjanteve të meveshëm, pasi përmban ndërtimin e landfillit të mbetjeve urbane, ndërtimin e landfillit të ujrave të ndotur, ndërtimin e landfillit të mbetjeve urbane, ndërtimin e vendepozitimit të hirit, ndërtimin e inceneratorit si dhe mbylljen dhe rehabilitimin mjedisor të vendepozitimit, problematika e menaxhimit të mbetjeve në Qarkut e Tiranës zgjidhet përfundimisht dhe me pas, lidhja e inceneratorit me sistemin elektroenergjetik shqiptar do të çojë në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të kësaj zone duke qënë se trajtimi i mbetjeve do të prodhojë energji elektrike

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i vendepozitimeve ekzistuese Tiranë.”



Projektvendimi i paraqitur për miratimin e Bonusit, është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe me kërkesat e nenit 100 të Kushtetutës, me ligjin Nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe pikës 6 të nenit 25, të ligjit Nr.125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar si dhe te Vendimit 575 date 10.07.2013 “Per miratimin e rregullave per identifikimin, vleresimin dhe dhenien me koncesion/partneritet publik privat’.

Projektvendimi gjithashtu nuk ka përplasje me akte të tjera në fuqi.

Ky projektvendim iniciohet në bazë të pikës 6 të nenit 25 të ligjit nr. 125/2013, ku përcaktohet se “*Propozuesit i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum 10 për qind të pikëve maksimale të garës*”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE***

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*, pasi bazohet vetëm në legjislacionin kombëtar.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim i propozuar miraton dhënien e Bonusit prej 8 (tetë) % te pikëve për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe administrimit e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Tiranë. Ky vlerësim ka ardhur nga Komisioni i dhënies me koncesion i ngritur me Urdhrin e Ministrit te Mjedisit Nr. 5007 datë 05.09.2016, “Për ngritjen e Komisionit për dhënien e

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”

konçesionit/partneritet publik privat me objekt ““Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vënddepozitimeve egzistuese Tiranë””. Komisioni i sipërcituar ka në përbërjen e tij edhe përfaqësues të Bashkisë Tiranë, ATRAKO-s dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Në mbledhjen e datës 04.11.2016, Komisioni vendosi që t’i propozojë Ministrisë së Mjedisit që shoqërisë poropozuese t’i jepet një bonus prej 8 % të pikëve sipas tabelës si vijon:

Kriteri	Maksimumi (pike)	Pikët
Analiza teknike e propozuar	3	2
Analiza mjedisore	3	3
Analiza financiare	2	1
Analiza energjetike (lidhja me sistemin)	2	2
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>8</b>

Në bazë të të dhënave të projekt propozimit, objektivi i projektit të propozuar është perpunimi i mbetjeve urbane të Qarkut të Tiranës, gjenerimi i energjisë dhe krijimi i vend depozitimit të ri të mbetjeve pas rehabilitimit mjedisor të vendepozitimit ekzistues. Më poshtë po detajojmë objektivat e projektit të propozuar:

1. Ndërtimi gjatë viteve 2017-2019 dhe venia në përdorim në vitin 2019 e Impiantit të perpunimit të mbetjeve urbane për Qarkun e Tiranës.
2. Krijimi i Energjisë së rinovueshme nga perpunimi i këtyre mbetjeve;



3. Rruajtje e ambjentit te kesaj zone permes rritjes se cilesise se ajrit, pastrimin e ambjentit dhe eleminimin e ndotjeve te ujrave siperfaqesor dhe nentokesor per kete zone;
4. Krijimin e vendeve te reja te punes per banoret e kesaj zone;

Edhe në Qarkun e Tiranës, ashtu si në shumicën e vendit, mbetjet në shumicën e zonave urbane mblidhen dhe transportohen nga kompani bashkiake ose private të mbledhjes së mbeturinave. Zonat rurale ende nuk mbulohen nga shërbime të menaxhimit të mbeturinave, popullsia gjen zgjidhje individuale të tilla si djegja ose hedhja jashtë vendeve të caktuara.

Mbeturinat zakonisht digjen në vende të hapura, duke shkaktuar ndotje të madhe në zonat përreth. Si pasojë banorët lokalë dhe kafshet janë të ekspozuar ndaj substancave toksike (dioksinë etj.) të cilat përbëjnë rrezik ndaj shëndetit të tyre. Duhet shtuar, se ka ndotje të ajrit dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Vendet ekzistuese ku hidhen mbetjet nuk janë të izoluara dhe nuk kanë masa të tjera mbrojtëse për të ndaluar ujërat nëntokësore nga depërtimi dhe rrjedhimisht çlirimi e kalimi metaleve të rënda e ndotësve të tjerë. Duhet shtuar se nuk ka sistem kullimi dhe nuk ka ndonjë pus afër këtyre vendeve që të përdoret për mbikëqyrje.

Në shumicën e rasteve mbeturinat industriale depozitohen në të njëjtat vende me mbetjet urbane duke sjelle efekte negative në mjedis.

Projekti i propozuar është një impiant i përpunimit të mbetjeve urbane (IPMU) me rikuperim të energjisë (Waste to Energy Plant- WTE) duke prodhuar energji elektrike.



Në sudimin e paraqitur nga shoqëria bëhet një përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve të projektit, implementimit të tij, situatës aktuale në menaxhimin e mbetjeve në Qark, objektivat e projektit të propozuar, situatës së prodhimit të mbetjeve në këtë territor, përshkrim I projektit, teknologjia që do të përdoret sëbashku me karakteristikat e impjantit, analiza SËOT, pagesat takuese për zhvillimin e konçesionit.

Analiza për *Vlerësimin cilësor për Vlerësimin e Vlerës së Parasë* (VVP) është bazuar në menaxhimin më të mirë të risqeve, si kapitali, kosto e kredisë, teknologjia, menaxhimi, etj.

Duke iu referuar analizës së risqeve, sektori privat rezulton më i aftë të menaxhojë risqet e identifikuar pasi projekti i propozuar kërkon nevoja të konsiderueshme kapitale kesh të cilat sektori privat i disponon dhe i ofron nëpërmjet këtij propozimi. Siç është llogaritur më parë ndërtimi i zbatimi i projektit sipas teknologjisë së propozuar kushton rreth 140 milion Euro pa përfshirë TVSH dhe pritet të investojë në një periudhë 30 vjeçare. Qartësisht një subjekt mbetet i avantazhuar pasi ofron një sasi të konsiderueshme kapitali menjëherë, të cilën sektori publik ose nuk është në gjëndje ta sigurojë (vështirësitë e marrjes hua për shkak të nivelit të borxhit) ose dhe në rastin më të mirë do bëhej një barrë për buxhetin e tij. Zgjidhja e propozuar ku Bashkitë ojesë e Qarkut do të paguajnë tarifën e depozitimit në këtë projekt mbi bazë të sasisë së mbetjeve që do të gjenerojë, rezulton një zgjidhje optimale dhe bën atë që ne quajmë partneritet publik-privat.

Projekti kërkon aftësi dhe profesionalizëm për menaxhimin e risqeve për teknologjinë dhe ndërtimin e një impianti kompleks, gjë që ka nevojë për eksperiencë, staf dhe aftësi menaxhim dhe teknologjike që sektori privat është

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë."

në gjëndje ti ofrojë më mirë sesa sektori publik. Edhe eksperiencia ndërkombëtare tregon dhe mbështet këtë fakt.

Propozuesi ofron një zgjidhje koncesionare afatgjatë (30 vite) e cila do të përfshijë investimin dhe menaxhimin për këtë periudhë. Nëpërmjet një marrëveshje afatgjatë sektori privat është i inkurajuar të ofrojë një shërbim cilësor sipas standarteve të performancës dhe që optimizon kostot e mirëmbajtjes në krahasim me një zgjidhje afatshkurtër.

Gjithashtu, Integrimi European i Shqipërisë shtroi detyrën imediate të njihen avantazhet që siguron filozofia PPP në çdo drejtim të administrimit apo menaxhimit të jetës ekonomike, politike dhe shoqërore shqiptare.

Skema e propozuar i lejon sektorit publik të përcaktojë nevojat dhe produktet dhe të kontrollojë siç duhet ato. Përcaktimi i produkteve dhe të ardhurave bazuar në të është një tjetër avantazh për PPP kundrejt prokurimit publik. Propozuesi ofron një zgjidhje interesante për sigurimin e të ardhurave bazuar në fuqinë e prodhuar (shitjen e energjisë tek KESH) ashtu dhe të ardhurat nga rikuperimi i materialeve të riciklueshme si plastikë dhe metalet (skrap-it). Kjo bën që koncesionari apo PPP bën sektorin privat të interesuar të ofrojë teknologjinë dhe menaxhimin më të mirë që maksimizon prodhimin dhe optimizon kostot (pra maksimizon vlerën e parasë), të cilën kontrata e prokurimit nuk e ofron dot. Kjo do të parandalojë performancën e dobët apo cilësinë e ulët të shërbimit.

**Përshkrimi I shkurtër i projektit të propozuar-** Projekti i propozuar për Zonën e Trajtimi të Mbeturina Tiranë (Z.T.M.T.) parashikon ndërtimin e objekteve të ndryshme kryesore.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”



Teknologjitë e ndryshme dhe instalimet e parapara në integrimin e Z.T.M.T janë parashikuar dhe dimensionuar për tu adresuar në menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta (inerte dhe mbetje urbane) të prodhuara në Qarkun e Tiranës. Z.T.M.T. është projektuar për të pritur dhe trajtuar nga 550 në 800 ton / ditë mbeturina në fillim të operimit (Viti i 1) dhe është në gjendje të pranojë sasi më të lartë nëse është e nevojshme brenda kohëzgjatjes së koncesionit dhe në rast të një rritje të prodhimit të mbetjeve në qarkun e Tiranës.

Projekti i propozuar konsiston në ndërtimin e katër objekteve kryesore.

- Ndërtimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane (IPMU) me rikuperim të energjisë (Ëaste to Energy Plant- ËTE) duke prodhuar energji elektrike.
- Ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, venddepozitimin e mbetjeve pas përpunimit në termovalorizator dhe atë të mbetjeve inerte.
- Ndërtimin e impiantit të riciklimit dhe stabilizimit të mbetjeve urbane.
- Ndërtimin e impiantit të përpunimit të ujrave të ndotur.

Dhe përkrah ndërtimit të objekteve të sipërpërmendura do të realizohet dhe kapsulimi final i venddepozitimit ekzistues.

Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane, termovalorizator, do të jetë i përbërë nga 4 (katër) linja përpunimi të ndara. Kapaciteti i përpunimit të secilës linjë do të jetë 230 ton/ditë. Të katërta linjat do të ndërtohen në faza, linja e parë është parashikuar të fillojë punë në muajin e tetëmbëdhjetë të koncesionit. Linja e dytë është parashikuar të fillojë punë në muajin e 36 (tridhjetë e gjashtë), linja e tretë në muajin 50 (pesëdhjetë). Linja e fundit është parashikuar që të fillojë punë para muajit të 72-të. Secila linjë do të ketë një kapacitet përpunues prej 230 ton/ditë dhe në total të katërta linjat një kapacitet prej 920 ton/ditë.

Në të njëjtën kohë ndërtimi i një sistemi të venddepozitimeve është planifikuar për të garantuar hedhjen e të gjithë mbeturinave dhe pas mbylljes përfundimtare të venddepozitimit ekzistues. Venddepozitimet e reja do të jenë të ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore të BE-së dhe legjislacionit shqiptar dhe do të parashikohen për lloje të ndryshme të mbeturinave.

Moduli i parë i venddepozitimit do të jetë operacional brenda 6 muajve nga fillimi i koncesionit. Ky venddepozitim i parë me një volum prej 1.67 milion m<sup>3</sup> do të jetë për mbeturinat e ngurta urbane. Ai është planifikuar për një jetëgjatësi prej 6 deri në 10 vjet, dhe do të lejojë nga muaji i gjashtë i funksionimit të koncesionit pas mbylljes së landfillit ekzistues, depozitimin e mbetjeve urbane në përputhje me rregulloren e BE-së.

Ndërtimi i një sistemi të mbulimit dhe kapjes së biogazit për venddepozitimin ekzistues patjetër do të zgjidhë temën e funksionimit të një venddepozitim të mos menaxhuar dhe efektet e saj të mundshme mjedisore negative.

Z.T.M.T. do të ketë venddepozitime të tjera të planifikuara për hedhjen e hirit nga objekti IPMU dhe mbetjet inerte.

Venddepozitimi për hedhjen e hirit të gjeneruara nga instalimi i IPMU do të ketë kapacitet prej 1.8 milion m<sup>3</sup> dhe është projektuar për një jetëgjatësi të projektuar prej 40 (dyzet) vjet. Përveç këtyre moduleve 2 venddepozitime të mëtejshme parashikohen për të marrë materiale inerte dhe jo të riciklueshme të ngurta me një kapacitet total prej 900,000 m<sup>3</sup> dhe një jetëgjatësi 40 (dyzet) vjet.



Z.T.M.T ka parashikuar dhe një zonë riciklimi dhe diferencimi, impiant stabilizimi dhe impiant të trajtimit të ujrave të ndotur.

Ndërtimi i impiantit të riciklimit dhe diferencimit është mjaft i rëndësishëm, sepse ai kryen një përzgjedhje të mbeturinave në hyrje. Objektivi kryesor është për të gjeneruar një fuqi kalorifike optimale për IPMU. Ndërtimi i këtij impianti do të fillojë me realizimin e këtij projekti dhe do të ketë kapacitet 550-800 ton / ditë. Impianti do të ketë një kombinim të selektimit mekanik dhe manual dhe do të sigurojë përfitime shtesë në lidhje me materiale të riciklueshme të tilla si, metal, qelq, plastik.

Klasifikim manual do të rrisë aktivizimin e fuqisë puntore në këtë projekt.

Është parashikuar instalimi i një impianti stabilizimi për fraksionet organike Fraksion Organik të mbetjeve që do të drejtohet në venddepozitim dhe për të garantuar një qëndrueshmëri më të mirë në venddepozitim.

Z.T.M.T. do të ketë impiant të trajtimit të ujrave të ndotur me kapacitet prej 400 m<sup>3</sup> / ditë që do të shërbejë për përpunimin e rrjedhave / ujërave të ndotura nga venddepozitimi ekzistues dhe nga venddepozitimet e reja. Ky impiant është e projektuar për të garantuar shkarkimin e rrjedhave sipas standardeve të BE-së për ujërave e zeza industriale.

Impianti është plotësuar nga të gjithë instalimin e funksionale të tilla si rrugët, zyrat, nënstacioni për lidhjen në rrjetin kombëtar ekzistues.

Koncepti i këtij projekti është i pari i këtij lloji në vend që kombinon menaxhimin e mbetjeve të ngurta (inerte dhe mbetje urbane) me përfitim në prodhimin e energjisë. Duhet theksuar se ky projekt është superior në krahasim me depozitimin direkt të mbeturinave, në aspektin e mjedisit, por edhe në aspektin ekonomik. Objektivi kryesor ka të bëjë me një menaxhim më të mirë të

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë."

mbetjeve të ngurta urbane, shfrytëzimin në jetëgjatësi të zonave të depozitimit dhe konvertimin në energji.

Ndërtimi i këtij impianti ka përparësi për këtë zonë dhe më gjerë, sepse nga njëra anë ka për qëllim depozitimin e mbetjeve të ngurta (inerte dhe mbetje urbane), një problem serioz në vend, dhe në anën tjetër teknologjia e trajtimit realizohet me praktikën më të mira duke minimizuar ndikimin negativ në mjedis dhe në zonën përreth. Ndërtimi dhe menaxhimi i të gjitha aktiviteteve propozohet të duke përmbushur kërkesat mjedisore në një nivel bashkëkohor gjatë ndërtimit dhe gjithë aktivitetit të impiantit. Për këtë arsye, krahas këtij studimi të fizibilitetit, një seri e studimeve gjeologjike, sizmike, etj janë kryer si pjesë dhe mbështetje për këtë propozim.

Projekti konçesionar I propozuar, parashikohet të realizohet brënda një periudhe 30 vjeçare ku 24 muaj prej të cilëve është koha e ndërtimit të tij dhe e vënjes në funksionim. Gjatë këtyre 24 muajve, do të mbyllet dhe rabilitohet fillimisht venddepozitimi aktual dhe do të ndërtohet venddepozitimi I ri I mbetjeve urbane, ai I ujrave të ndotur dhe I inerteve. Më pas do të vazhdohet me pjesën tjetër të projektit sepse sikurse e cituam edhe më sipër, projekti është kompleks dhe kalon nëpër 6 module (faza) të ndërtimit dhe fillimit të operimit të tij. Në përfundim të periudhës konçesionare, do të jetë Bashkia Tiranë, në cilësinë e përfituesit të projektit, të marrë në dorëzim një impiant funksional, benefitet mjedisore dhe financiare të të cilit të jenë që në momentin e parë të dorëzimit.

Implementimi i këtij projekti do të fillojë në vitin 2017, impianti vihet në punë në fillim të vitit 2018.



Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për ndërtimin e të tërë impiantit përfshi edhe inceneratorit në vëndin e përcaktuar vlerësohet te jete i pranueshëm ne kuadrin e një projekt propozimi.

Komisioni i dhënies së konçesionit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Integrated Energy B.V.” shpk, si dhe ne ligjin nr. 125/2013, date 25.04.2013, konkludon se:

**Projekt-ideja për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe reabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve urbane të Qarkut Tirane, e paraqitur si propozim i pa kërkuar nga shoqëria “Integrated Energy B.V” sh.p.k., është me interes publik.**

Koha e paraqitjes së propozimit të pakërkuar, daton në muajin qershor të këtij viti, ndërkohë që pas përgjigjes së Ministrisë së Mjedisit ku shpreh interesin e saj dhe fton subjektin për të bërë një propozim më konkret, subjekti propozues ka paraqitur studimin ekonomik-financiar, studimin e fizibilitetit, eksperiencat dhe referencat e shoqerive, studimin teknik, Vleresimin e Ndikimit në Mjedis.

Projekti i propozuar më sipër për qarkun Tiranë, Republika e Shqipërisë bazuar në formën e operimit “BOT” ( Built, Operate, Transfer), sipas skemës së Partneriteti Publik Privat.

Lidhur me statusit juridik të shoqërisë, sqarojmë se subjekti është i regjistruar konform ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit. Subjekti është në ortakëri me subjektin “Paul Ęurth Italia s.p.a” & “Energy Recuperator s.p.a. Sqarojmë se subjekti “Paul Ęurth Italia s.p.a”është nga gjigandët botëror të ndërtimit dhe instalimit të furrave dhe prosdhimit të hekurit në të gjithë botën.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”

Shoqëria propozuese ka disa ortakë, pasi impjanti është kompleks dhe kërkon teknologji dhe ekspertizë të ndryshme për pjesën e lanfliitit, të ndryshme për pjesën e incenerimit.

Gjithashtu, sqarojmë se në vlerësimin e projekt-idesë, eksperiencia e shoqërisë nuk ka qënë kriter vlerësues pasi vlerësohet efiçenca e studimit të paraqitur jo studio hartuese apo subjekti paraqitës.

Duke qënë se kemi të bëjmë me një akt me karakter individual dhe është një projektvendim dhe jo ligj, propozimi nuk ka kaluar përmes procesit të konsultimit publik. Akti i propozuar nuk bën asgjë më shumë a më pak sesa i akordon një subjekti që ka paraqitur një propozim të pakërkuar një bonus në raport me subjektet e tjera në rast se ky do të bëhet pjesë e garës konkurruese për të fituar kontratën e konçesionit. Subjekti përfitues i bonusit, përveç propozimit të pakërkuar, ka paraqitur një studim fizibiliteti, studim ky i cili nga ana e Komisionit të Dhënies së Konçesionit është konsideruar fizibël, me interes për ekonominë dhe në përputhje me Programin e Qeverisë dhe politikat e Ministrisë së Mjedisit. Sikurse citohet edhe në titullin e projektaktit, dhënia e bonusit është konsideruar për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me konçesion të ndërtimit dhe administrimit e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë. Është e nevojshme të kemi parasysh që ai është një dokument i cili nuk mund t'i njoftohet të gjithë autoriteteve pasi përmban të dhëna konfidenciale dhe në asnjë rast legjislacioni ku bazohet ky projektakt nuk parashikon që t'i njoftohen publikut apo autoriteteve të tjera të dhëna teknike dhe financiare mbi projektin në fazën e dhënies së bonusit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë."



Institucioni kryesor që ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi është Ministria e Mjedisit.

Gjatë përgatitjes së DSK-ve, Autoriteti Kontraktues, Ministria e Mjedisit do të përcaktojë në mënyrë të qartë kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin projektet koncesionare në çdo fazë të realizimit të tyre në përputhje me mendimet e ministrive, fusha e veprimtarise se te cilave mund te ndikohet nga projekti ne fjale.

#### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Mjedisit dhe do të dërgohet për mendim pranë pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministres se Shtetit per Mardheniet me Parlamentin Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si dhe MZHETTS.

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i projektvendimit nuk shoqërohet me shpenzime financiare për buxhetin e shtetit, pasi ky projektakt vlerëson dhe i jep një të drejtë që ia jep ligji propozuesit të pakërkuar.

Vetë procedura koncesionare nëse do të ketë një ofertues fitues dhe një kontratë të lidhur, nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit, pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat, madje buxhetit të shtetit do ti shtohet vlera e Fee koncesionare që do të detyrohet të paguajë subjekti.

Në përfundim, ritheksojmë se kursesi ky akt nuk parashikon efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë."

**PROPOZUESI**

**Lefter KOKA**



**MINISTRI I MJEDISIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me konçesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.”